



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
KOMUNA E DRENASIT



Zyra e Kryetarit

01 Nr. 463/03-44478 . dt. 16.10 2020

Në bazë të nenit 11 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nenit 4 dhe nenit 11 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të dt. 28 tetor 2010 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës), të dispozitave të nenit 83 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Vendimit të Kuvendit Komunal të Drenasit 12 Nr.400/01-28798, dt. 30.07.2020 për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm Publik të pjesës së ngastrës kadastrale 120/0, Kryetari i Komunës së Drenasit si organ shpronësues me datë 16.10.2020, merr këtë:

VENDIM PËRFUNDIMTAR

1. **MIRATOHET** shpronësimi i Njësisë Kadastrale në Zonën Kadastrale në Poklek sipas Listës së bashkangjitur në formë tabelare e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi, për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik realizimi i projektit “Zgjerimi, modernizimi dhe kompletimi i infrastrukturës përcjellëse të Stadionit të Qytetit Rexhep Rexhepi” në Poklek të Ri., sipas Vendimit të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit 12 Nr.400/01-28798 të dt.30.07.2020..
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është Akti i Vlerësimit i punuar nga Zyra për vlerësimin e pronës së paluajtshme/Ministria e Financave dhe lista në formë tabelare e cekur në pikën 1 të këtij Vendimi në të cilën është përcaktuar shuma e kompensimit për pronar apo zotërues të interesit, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të të cilëve janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, organi shpronësues i dërgon Vendimin Përfundimtar personave të identifikuar në listen e paraqitur në formë tabelare e cekur në pikën 1 të këtij Vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Vendimi Përfundimtar do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një Gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij Vendimi brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas hyjes në fuqi të tij, kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Gjykatën Themelore Prishtinë – Dega në Gllogoc çdo person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën ose të drejtat pronësore të prekura nga Vendimi Përfundimtar, si dhe çdo person i interesuar i cili pretendon se ka një interes të drejtëpërdrejtë në pronën e paluajtshme, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në vendim, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit në përputhje me nenet 36 dhe 37 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet

RiL

dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 datë 28 tetor 2010 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.91).

6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në Gjykatën Kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë pesë (5) kopje të ankesës të cilat do të dorëzohen fizikisht në Zyrën Ligjore të Organit Shpronësues – Komuna e Drenasit, duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse.
7. Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që brenda afatit prej dy (2) vite, që të paguaj plotësisht shumën e kompensimit sipas Aktit të Vlerësimit të përgatitur nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe titujve juridik të cilët i kanë paraqitur pronarët me rastin e vërtetimit të drejtës së Pronësisë mbi Njësitë Kadastrale.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarit të ri si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hynë në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një Gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.



Iu dërgohet:

- Pronarëve ose Zotëruesve të interesit
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
- Arkivit të Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/ VLADA KOSOVO / GOVERNMENT OF KOSOVO
Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance
Departamenti i Tatimit në Pronë

Komuna Drenas Zona Kadastrale: Poklek									
Të dhënat sipas Elaboratit / Fletës Poseduese							Vlerësimi sipas ZVPP-së		
Nr.	Pronar	Nr.i Pronës	Kultura / Klasa- Shfrytëzimi aktual	Sipërfaqja e Përgjithshme m ²	Sipërfaqja për shpronësim m ²	Sipërfaqja e mbetur m ²	Vlera e investimeve €	Çmimi i tokës €/m ²	Totali (€)
1	Sadri Hasan Muqolli	120-0	are kl 2,3,4,5	3725	1413	2312		24.00	33,912.00
TOTAL									33,912.00

